

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

“WVP Fund Management Tirana” sh.a.

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-30

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e “WVP Fund Management Tirana” sh.a,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “WVP Fund Management Tirana” sh.a – shoqëri administruese e fondeve të sipermarrjeve të investimeve kolektive (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. .

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
25 prill 2020

Kledion Kasha, FCA

Kasha



Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Aktivet Afatgjata			
Aktive Afatgjata Jomateriale	7	3,623,945	3,814,677
Aktive Afatgjata Materiale	8	2,450,072	719,467
Totali i Aktiveve Afatgjata		6,074,017	4,534,144
Aktivet Afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme dhe parapagime	9	434,952	595,582
Depozita me afat	10	10,056,164	10,056,164
Mjete Monetare dhe ekuivalentët me to	11	11,299,820	12,000,502
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		21,790,936	22,652,248
TOTALI I AKTIVEVE		27,864,953	27,186,392
KAPITALI			
Kapitali aksionar	12	28,600,000	28,600,000
Humbje të mbartura		(1,768,607)	(236,764)
Humbja e vitit		(1,284,219)	(1,531,843)
Totali i Kapitalit		25,547,174	26,831,393
DETYRIMET			
Detyrimet Afatgjata			
Detyrimet e Qirasë	13	1,526,748	-
Totali i detyrimeve afatgjata		1,526,748	-
Detyrimet Afatshkurtra			
Detyrimet e Qirasë	13	335,755	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	14	455,276	354,999
Totali i detyrimeve afatshkurtra		791,031	354,999
TOTALI I DETYRIMEVE		2,317,779	354,999
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		27,864,953	27,186,392

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë "WVP Fund Management Tirana" sh.a. më 31 mars 2019 dhe janë firmosur nga:

Z. Arton Lena
Administrator i Përgjithshëm



Znj. Rrezarta Qerimi
Kontabiliste

Rrezarta Qerimi:

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga tarifat e administrimit	15	7,097,024	4,829,851
Të ardhurat nga interesat	16	359,234	278,121
Shpenzime interesi		(123,581)	-
Humbje nga shitja e letrave me vlerë		-	(204,718)
		7,332,677	4,903,254
Shpenzime për personelin	17	(3,471,339)	(4,197,340)
Shpenzime të përgjithshme administrative	18	(4,385,073)	(1,841,270)
Shpenzime amortizimi	7, 8	(755,902)	(355,616)
		(8,612,314)	(6,394,226)
Fitim/(humbja) nga kursi i këmbimit		(4,581)	(40,871)
Fitimi/(humbja) para tatimit		(1,284,219)	(1,531,843)
Tatim mbi fitimin	19	-	-
Fitimi/(humbja) neto pas tatimit		(1,284,219)	(1,531,843)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Total i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Total i fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:		(1,284,219)	(1,531,843)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i paguar	Humbje e mbartur	Humbje e periudhës	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	22,000,000	-	(236,764)	21,763,236
Mbartja e humbjes së periudhës paraardhëse	-	(236,764)	236,764	-
Humbja neto e vitit	-	-	(1,531,843)	(1,531,843)
Rritje në kapital	6.600.000	-	-	6.600.000
Gjendja më 31 dhjetor 2018	28,600,000	(236,764)	(1,531,843)	26,831,393
Mbartja e humbjes së periudhës paraardhëse	-	(1,531,843)	1,531,843	-
Humbja neto e vitit	-	-	(1,284,219)	(1,284,219)
Rritje në kapital	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	28,600,000	(1,768,607)	(1,284,219)	25,547,174

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fluksi parasë nga aktiviteti operacional			
Fitimi/(humbja) para tatimit		(1,284,219)	(1,531,843)
<i>Rregullime për:</i>			
Të ardhurat nga interesat	15	(359,234)	(278,121)
Shpenzime interesi		123,581	-
Shpenzime amortizimi	6.7	755,902	355,616
		(763,970)	(1,454,348)
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>			
Rritje në llogari të arkëtueshme dhe parapagime	8	160,630	(575,582)
Rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	13	100,277	174,571
Rënie\ Rritje në të pagueshme ndaj aksionarëve		-	(22,860)
		(503,063)	(1,878,219)
Interes i arkëtuar		359,234	221,957
Interes i paguar		(123,581)	-
Tatim fitim i paguar	8	-	(20,000)
Rrjedhja e parasë neto e gjeneruar në aktivitetin operacional		(267,410)	(1,676,262)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	6	-	(3,963,300)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	7	(87,500)	(184,140)
Vënie depozite	9	-	(10,000,000)
Rrjedhja e parasë neto e përdorur nga aktivitetet investuese		(87,500)	(14,147,440)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritja e kapitalit	11	-	6,600,000
Pagesa e Detyrimeve të Qirasë		(345,772)	
Rrjedhja neto nga aktivitetet financuese		(345,772)	6,600,000
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj		(700,682)	(9,223,702)
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fillim të periudhës		12,000,502	21,224,204
Mjete Monetare dhe ekuivalentë në fund të periudhës	10	11,299,820	12,000,502

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 30 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

WVP Fund Management Tirana Sh.a (“Shoqëria”) është një shoqëri aksionare shqiptare me seli në Tiranë, e cila ka si objekt të veprimtarisë mbledhjen dhe investimin e fondeve të investimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.10198, datë 10/12/2009 "Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut. Anëtarët e fondit marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit dhe gjithashtu mund të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave të tyre. Shoqëria është e licënuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri bazuar në Liçensën nr.4, datë 31 Janar 2018.

Shoqëria u regjistrua në Qendrën Kombëtare Shqiptare të Regjistrimit më 15 Nentor 2017, dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas neneve të ligjit nr.9901, datë 14 prill 2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", dhe me aktet nënligjore të tij. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në Rruga "Barrikadave", nr. 118, kati 4, ap. 1.

Shoqëria është e licënuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri bazuar në Liçnesen nr.4, datë 31 Janar 2018.

Shoqëria administron fondin e investimeve kolektive WVP TOP INVEST të organizuar si një fond investimi i hapur i cili është një grumbullim i veçantë asetesh i paregjistruar si person juridik, mbajtësit e kuotave të të cilit kanë të drejtë për një pjesë proporcionale në fitimet e fondit dhe kanë të drejtë në çdo kohë të kërkojnë shlyerjen e kuotave dhe daljen nga fondi.

Fondi WVP TOP INVEST u krijua në bazë të licencës Nr.4, datë 31.01.2018 të Shoqërisë administruese “WVP Fund Management Tirana” sh.a të akorduar nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me vendim Nr. 14, datë 31.01.2018 - Për ushtrim veprimtarie në administrimin e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka punësuar 5 punonjës (2018: 6). Numri mesatar i punonjësve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 6 punonjës (2018: 5 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare (këtu e më poshtë referuar “pasqyrat financiare”) janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe legjislacionit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 4, të cilat janë të bazuara në kërkesat për raportim sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (“BNSK”). Më poshtë paraqiten politikat kontabël kryesore të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Detaje për politikat kontabël të Shoqërisë, janë përfshirë në Shënimin 4

2.2 Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në lekë.

2.4 Parimi i Vijimesise

Shoqëria është në vitin e dytë të biznesit dhe që nga krijimi i saj ka pësuar humbje financiare pasi të ardhurat e gjeneruara nuk kanë arritur të mbulojnë shpenzimet e saj. Gjatë vitit 2019 shoqëria ka rritur të ardhurat me 47%. Shoqëria mori vendim në Këshill të Administrimit për krijimin e një fondi të ri investimi në monedhën Euro. Shoqëria, gjithashtu, vazhdon të ketë një situatë të kënaqshme likuiditeti ku aktivet afatshkurtra i tejkalojnë detyrimet afatshkurtra me rreth 28 herë si rezultat i rritjes së vlerës së fondeve të saj nën administrim dhe në përgjithësi nuk është e financuar me borxhe nga palë të treta.

Shoqëria bazohet kryesisht në mbështetjen e aksionerëve të saj për të financuar vitet e para të aktivitetit, të cilët kanë qëllimin për të mbështetur financiarisht Shoqërinë, nëse lind nevoja, dhe kanë konfirmuar me shkrim këtë.

Bazuar në sa më lart, Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë e saj në vijimësi, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimesisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

3. Standardet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara

3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019

SNRF 16 "Qiratë"

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse (KIRFN 4 “Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban një Qira”, KIS “15 Qiraja Operative – Incentivat” dhe KIS 27 “Vlerësimi i Thelbit të Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qiradhënies”).

Miratimi i këtij Standardi të ri ka rezultuar që Shoqëria të njohë një aktiv të të drejtës së përdorimit dhe detyrimet e qirasë në lidhje me të gjitha kontratat e qirasë operative të mëparshme, përveç atyre të identifikuar si me vlerë të ulët ose që kanë një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj nga data e aplikimit fillestar.

Standardi i ri është aplikuar duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, me efektin kumulativ të miratimit të SNRF 16 të njohur në kapital si një rregullim në gjendjen fillestare të humjeve të mbartura për periudhën aktuale. Periudhat e mëparshme nuk janë riparaqitur.

Për kontratat në fuqi në datën e aplikimit fillestar, Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë përkufizimin e qirasë nga SNK 17 dhe KIRFN 4 dhe nuk ka zbatuar SNRF 16 për marrëveshjet që më parë nuk ishin të identifikuar si qira sipas SNK 17 dhe KIRFN 4.

Shoqëria ka zgjedhur të mos përfshijë kostot fillestare direkte në matjen e aktivitetit të të drejtës së përdorimit për qiratë operative që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar të SNRF 16, që është 1 janar 2019. Në këtë datë, Shoqëria ka zgjedhur gjithashtu të masë aktivitetet e të drejtës së përdorimit në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë të rregulluar për parapagimet ose pagesat e përllogaritura të qirasë që kanë ekzistuar në datën e tranzicionit.

Në vend që të kryejë një rishikim të zhvlerësimit të aktivitetit të të drejtës së përdorimit në datën e aplikimit fillestar, Shoqëria është mbështetur në vlerësimin e saj historik nëse ka patur detyrime konstruktive të qirasë përpara datës së aplikimit fillestar të SNRF 16.

Në tranzicion, për qiradhëniet e llogaritura më parë si qira operative me një afat të mbetur të qiradhënies prej më pak se 12 muaj dhe për qira të aktiveve me vlerë të ulët, Shoqëria ka aplikuar opsionin e përjashtimit duke mos njohur aktivitetet e të drejtës së përdorimit, por duke llogaritur shpenzimet e qirasë në bazë lineare për afatin e mbetur të qirasë.

Për ato qira të klasifikuara më parë si qira financiare, aktivi i së drejtës së përdorimit dhe detyrimi i qirasë maten në datën e aplikimit fillestar në të njëjtat shuma si në SNK 17 menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar.

Në kalimin në SNRF 16, norma mesatare e ponderuar e interesit e huamarrjes e aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 6%.

3 Standardet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara (vazhdim)

3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019 (vazhdim)

SNRF 16 "Qiratë" (vazhdim)

Tabela në vijim paraqet një rakordim të zërave të pasqyrave financiare nga SNK 17 në SNRF 16 më 1 janar 2019:

	31 dhjetor 2018	Riparaqitje e balancave hapëse	1 janar 2019
Aktivët afatgjata materiale	926,460	2,208,275	3,134,735
Detyrime të Qirasë	-	(2,208,275)	(2,208,275)
Totali	926,460	-	926,460

Tabela në vijim paraqet një rakordim të angazhimeve totale të qirasë operative më 31 dhjetor 2018 me detyrimet e qirasë të njohura më 1 janar 2019:

Angazhimet totale të qirasë operative të paraqitura më 31 dhjetor 2018	370,260
Përrjashtimet nga njohja:	
Qiratë e aktiveve me vlerë të ulët	-
Qiratë me afat të mbetur të qirasë më pak se 12 muaj	-
Pagesat e qirave të panjohura	-
Rregullime të tjera të vogla në lidhje me shpalosjet e angazhimeve	-
Detyrimet e qirasë operative para zbritjes	370,260
Zbritur duke përdorur normën rritëse të huamarrjes	(104,489)
Zgjatja e afatit të qirasë	1,942,504
Detyrimet totale të qirasë të njohura sipas SNRF 16 më 1 Janar 2019	2,208,275

3.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por që nuk janë ende efektive, ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria.

Drejtimi parashikon që të gjitha Standardet përkatëse do të miratohen në periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të Standardit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur në shënime shpjeguese pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria në të gjitha periodat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerë me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR	121.77	123.42

4.2. Plani i Kontributeve të Përcaktuara

Nën planin e kontributeve të përcaktuara, shumat e përfitimeve të ardhshme është përcaktuar nga kontributet e paguara dhe nga interesat e fituara të fondit. Detyrimet janë njohur në fitim apo humbje në periudhën e duhur dhe janë paraqitur interesat të shtuara të fondit të investimit nga të ardhurat nga investimet.

4.3. Instrumentat Financiare

4.3.1. Njohja dhe çregjistrimi

Aktivët dhe detyrimet financiarë njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivët financiarë transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.3. Instrumentat Financiare (vazhdim)

4.3.2. Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Shoqëria aktualisht ka vetëm aktive financiare të klasifikuara me kosto të amortizuar

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitetit financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

4.3.3. Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

i) Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Aktivet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, shumica e të arkëtueshmeve të tjera, si dhe obligacioneve të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39 bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

4.3.4. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.3. Instrumentat Financiare (vazhdim)

4.3.4. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 dhjetor 2019.

4.4. Mjete monetare dhe ekuivalentë

Mjete monetare në arkë dhe bankë përfshin gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

4.5. Depozita me afat

Depozitat me afat janë vendosur në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe janë klasifikuar si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi është përlogaritur në baza përlogaritje dhe interesi i arkëtueshëm është pasqyruar në të arkëtueshme të tjera.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.6. Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e softëare-ve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentet kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii) Zhvlerësimi

Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën e vlerës së mbetur. Aktivet me qira zhvlerësohen për më të voglën mes periudhës së qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme.

Norma e amortizimit vjetor është si me poshtë:

Pajisje zyre	20%
Pajisje informatike	25%

4.7. Aktive të patrupëzuara

Aktivitet të patrupëzuara njihen me kosto historike, zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, bazuar në metodën e vlerës së mbetur. Norma e amortizimit vjetor është 25%.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.8. Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktivi, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke zbritur zhvlerësimin apo amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

4.9. Aktivitetet e marra me qira

Siç përshkruhet në Shënimin 3.2, Shoqëria ka aplikuar SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive dhe për këtë arsye informacioni krahasues nuk është riparuar. Kjo do të thotë që informacioni krahasues është raportuar ende nën SNK 17 dhe KIRFN 4.

4.9.1. Politikat kontabël të zbatueshme nga 1 janari 2019

Për çdo kontratë të re të lidhur më ose pas 1 janarit 2019, Shoqëria konsideron nëse kontrata është, ose përmban një qira. Një qira përcaktohet si “një kontratë, ose pjesë e një kontrate, që përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv (aktivin e kontratës) për një periudhë kohe në këmbim të një shume”.

Për të zbatuar këtë përkufizim, Shoqëria vlerëson nëse kontrata përmbush tre vlerësime kryesore, të cilat janë:

- kontrata përmban një aktiv të identifikuar, i cili ose përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratë ose specifikohet në mënyrë të shprehur duke u identifikuar në kohën kur aktivi i vihet në dispozicion Shoqërisë
- Shoqëria ka të drejtë të sigurojë në tërësi të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit, duke marrë parasysh të drejtat e tij në fushën e caktuar të kontratës
- Shoqëria ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e aktivitetit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Shoqëria vlerëson nëse ka të drejtë të përcaktojë “si dhe për çfarë qëllimi” përdoret aktivi gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.9. Aktivet e marra me qira (vazhdim)

4.9.1. Politikat kontabël të zbatueshme nga 1 janari 2019 (vazhdim)

Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh një aktiv të të drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në bilanc. Aktivet e të drejtës së përdorimit maten me kosto, e cila është e përbërë nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e bërë nga Shoqëria, një vlerësim i çdo kostoje për çmontimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivit në fund të qirasë, dhe çdo pagesë e qirasë e bërë përpara datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo incentivë të marrë).

Shoqëria amortizon aktivet e të drejtës së përdorimit në bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të të drejtës së përdorimit ose përfundimit të afatit të qirasë. Shoqëria gjithashtu vlerëson aktivin e të drejtës së përdorimit për zhvlerësim kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, Shoqëria mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, të skontuara duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira nëse kjo normë është lehtësisht e disponueshme ose normën rritëse të huamarrjes të Shoqërisë.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesat fikse, pagesat e ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet sipas një garancie të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet për të cilat ka një siguri të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të zvogëlohet për pagesa të bëra dhe rritet për interesin. Detyrimi do të rivlerësohet për të pasqyruar çdo rivlerësim ose modifikim, ose nëse ka ndryshime në pagesa fikse në thelb.

Kur detyrimi i qirasë është rivlerësuar, rregullimi përkatës pasqyrohet në aktivin e të drejtës së përdorimit, ose fitimin dhe humbjen nëse aktivi i të drejtës së përdorimit është zvogëluar tashmë në zero.

Shoqëria ka zgjedhur të kontabilizojë qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur lehtësimet praktike. Në vend që të njohin një aktiv të të drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me këto njihen si shpenzime në fitim ose humbje mbi baza lineare gjatë afatit të qirasë.

Në pasqyrën e pozicionit financiar, aktivet e të drejtës së përdorimit janë përfshirë në aktivet afatgjata materiale dhe detyrimet e qirasë janë paraqitur më vete.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.9. Aktivet e marra me qira (vazhdim)

4.9.2. Politikat kontabël të zbatueshme përpara 1 janarit 2019

Shoqëria si qiramarrës

(i) Qiratë financiare

Drejtimi zbaton gjykim në marrjen në konsideratë të thelbit të marrëveshjes së qirasë dhe nëse transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e lidhura me pronësinë e aktivitetit të dhënë me qira. Faktorët kryesorë të konsideruar përfshijnë kohëzgjatja e afatit të qirasë në lidhje me jetën ekonomike të aktivitetit, vlera aktuale e pagesave minimale të qirasë në lidhje me vlerën e drejtë të aktivitetit, dhe nëse Shoqëria fiton pronësinë mbi aktivin në fund të afati të qirasë.

Për qiradhëniet e tokave dhe ndërtesave, pagesat minimale të qirasë së pari shpërndahen për secilin komponent, bazuar në vlerat e drejta relative të interesave të qirasë përkatëse. Çdo komponent vlerësohet më pas për trajtimin e mundshëm si një qira financiare, duke marrë parasysh faktin se toka normalisht ka një jetë të pacaktuar ekonomike.

Shih Shënimin 4.5 për metodat e amortizimit dhe jetën e dobishme për aktivet e mbajtura nën qira financiare. Elementi i interesit të pagesave të qirasë ngarkohet në fitim ose humbje, si kostot e financimit gjatë periudhës së qirasë.

(ii) Qiratë operative

Të gjitha qiratë e tjera trajtohen si qira operative. Kur Shoqëria është një qiramarrës, pagesa në marrëveshjet e qirasë operative njihet si shpenzim në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Kostot e lidhura, të tilla si mirëmbajtja dhe sigurimi, shpenzohen siç ndodhin.

4.10. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar paraqitet në vlerën e tij nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i papaguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

4.11. Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan kontribute shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione.

(ii) Kontributet shoqërore vullnetare

Shoqëria paguan kontribute shoqërore vullnetare për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.12. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat e shoqërisë do të jenë kryesisht regjistrimi i letrave me vlere. Shoqëria ka qene ne procedura licensimi dhe deri me 31 Dhjetor 2019 dhe ende nuk ka filluar regjistrimi i titujve.

Për të përcaktuar nëse do të njohë të ardhurat, Shoqëria ndjek një proces me 5 hapa:

1. Identifikimi i kontratës me një klient
2. Identifikimi i detyrimeve të performancës
3. Përcaktimi i çmimit të transaksionit
4. Alokimi i çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës
5. Njohja e të ardhurave kur / si detyrimet e performancës janë të kënaqur.

Në të gjitha rastet, çmimi i përgjithshëm i transaksionit për një kontratë ndahen në mes të performancës së ndryshme bazuar në çmimet relative të shitjeve të tyre të pavarura. Çmimi i transaksionit për një kontratë përfshijon çdo shumë të mbledhur në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen në një moment në kohë ose përgjatë kohës, kur Shoqëria përmbush detyrimet e performancës duke transferuar shërbimet e premtuara për klientët e saj.

Shoqëria njeh detyrime kontraktuale për shumat e arkëtuara në lidhje me detyrimet e performancës të papërmbushura dhe raporton shumat të tilla si detyrime të tjera në pasqyrën e pozicionit të pozicionit financiar. Në mënyrë të ngjashme, nëse Shoqëria përmbush një detyrim të performancës përpara se të arkëtojë, Shoqëria njeh ose një aktiv të kontratës ose një të arkëtueshme në pasqyrën e tij të pozicionit financiar, në varësi të faktit nëse kërkohet diçka tjetër përveç kohës së kalimit para se të bëhet pagesa.

4.13. Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave të tjera. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi, ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme sipas ligjit shqiptar të tatimit.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ky aktiv mund të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë impaktin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe tatimet dhe interesat shtesë. Shoqëria beson se përlogaritjet për detyrimet tatimore janë të mjaftueshme për të gjithë vitet e hapura tatimore në bazë të vlerësimit të shumë faktorëve duke përfshirë interpretimet tatimore dhe eksperiencat e mëparshme.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.14. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur. Shpenzimet për garancitë njihen dhe ngarkohen kundrejt provizionit përkatës në momentin që njihet e ardhura e lidhur me to.

4.15. Provizionet, aktivet e kushtëzuara dhe detyrimet e kushtëzuara

Një provizion njihet kur shoqëria ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për vlerën e detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të duhen për të shlyer detyrimin, duke përdorur një normë skontimi e cila përfaqëson vlerësimin aktual të vlerës në kohë të parashikuar dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja e provizionit me kalimin e kohës njihet si shpenzim interesi.

Provizionet për garancitë, mosmarrëveshjet ligjore, ose pretendimet e tjera njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, është e mundur që nga Shoqërisë t'i kërkohej një dalje e burimeve ekonomike dhe shumat mund të vlerësohet me besueshmëri. Koha ose shumta e rrjedhjes mund të jenë ende të paqarta.

Provizionet e ristrukturimit njihen vetëm nëse ekziston një plan i detajuar formal për ristrukturimin dhe drejtimin ose ka komunikuar karakteristikat kryesore të planit ndaj atyre të prekur ose ka filluar zbatimin. Rezervat nuk njihen për humbjet e ardhshme operacionale.

Provizionet maten si shpenzimet e parashikuara për të shlyer detyrimin aktual, bazuar në evidencën më të besueshme të disponueshme në datën e raportimit, duke përfshirë rreziqet dhe pasiguritë që lidhen me detyrimin aktual. Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, probabiliteti që një dalje e mjeteve monetare do të kërkohej për shlyerjen e detyrimit përcaktohet duke marrë parasysh klasën e detyrimeve në tërësi. Provizionet skontohen në vlerat e tyre aktuale, ku vlera kohore e parashikuar është materiale.

Çdo rimbursim që Shoqëria është praktikisht e sigurt për të mbledhur nga një palë e tretë në lidhje me detyrimin njihet si një aktiv i veçantë. Sidoqoftë, ky aktiv nuk mund të tejkalojë shumën e provizionit përkatës.

Një detyrim nuk njihet nëse një dalje e burimeve ekonomike si rrjedhojë e detyrimeve aktuale nuk është e mundur. Situata të tilla paraqiten në shënimet shpjeguese si detyrime të kushtëzuara, përveçse kur pakësimi i burimeve ka pak gjasa që të ndodhë.

4.16. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe manaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.17. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare sipas SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë vlerësime, gjykime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshme dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

4.17.1. Gjykime të rëndësishme kontabël

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njihet detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksat shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojnë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

4.17.2. Çmuarjet

Informacioni rreth vlerësimeve dhe supozimeve që mund të kenë efektin më të rëndësishëm në njohjen dhe matjen e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve janë dhënë më poshtë. Rezultatet aktuale mund të jenë thelbësisht të ndryshme.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të miratuara nga vetë Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, si për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jofinanciare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe prezantimit. Aty ku është e aplikueshme, informacionet e mëtejshme në lidhje me supozimet e bëra në përcaktimin e vlerave të drejta janë paraqitur në shënimet specifike për atë aktivet ose detyrimet.

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që vlera e drejtë e parasë dhe e parasë së ngurtësuar, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, aktiveve të tjera afatshkurtra dhe detyrimeve të tjera afatshkurtra dhe detyrimit për tatim fitimin, përafrohet me vlerën kontabel kryesisht për shkak të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

4. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.17. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

4.17.2. Çmuarjet (vazhdim)

Jetë e dobishme e pasurive të zhvlerësueshme

Drejtimi rishikon vlerësimin e tij të jetës së dobishme të pasurive të amortizueshme në çdo datë raportimi, bazuar në dobinë e pritshme të aktiveve. Pasiguritë në këto vlerësime kanë të bëjnë me vjetërsimin teknologjik që mund të ndryshojë dobinë programeve kompjuterike dhe pajisjeve informatike të caktuara.

4.18. Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

5. Manaxhimi i rrezikut financiar

5.1. Faktorët e rrezikut financiar

Shoqëria monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të rrezikut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e rrezikut. Shoqëria nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve. Shoqëria gjatë aktivitetit të saj ekspozohet ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- 1) Rreziku i kreditimit
- 2) Rreziku i likuiditetit
- 3) Rreziku i tregut
- 4) Rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, si dhe politikat dhe procedurat për administrimin e këtyre risqeve.

5.2. Kuadri i Administrimit të Rrezikut

Politikat janë zhvilluar në bazë të strukturës së Fondit të Investimit dhe tolerancës së rrezikut të vendosur në politikën e investimeve. Skema e fondeve është e tillë që kontributet janë të përcaktuara, ndërsa përfitimet nuk janë të përcaktuara. Ndarja kryesore është që rreziku mbahet plotësisht nga klientët që kontribuojnë. Toleranca e rrezikut është elementi kryesor që përcakton diferencën midis fondeve nën administrim dhe që së bashku me skemën me kontribute të përcaktuara të fondit, qëndrojnë në thelb të zhvillimit të politikës së menaxhimit të rrezikut.

Për të menaxhuar rrezikun e tregut financiar, Shoqëria ndërmerr një proces që përbëhet nga identifikimi i ekspozimeve, vendosja e limiteve të lejuar të këtyre ekspozimeve, matjen e vazhdueshme të ekspozimeve, monitorimin e limiteve, dhe ekzekutimin e axhustimeve të duhura sadoherë nivelet e ekspozimit gjenden jashtë intervaleve të caktuara, apo dhe menaxhimin e pozicioneve me anë të kontratave derivative. Shoqëria përdor kontratat derivative për fondet vetëm për qëllime eliminimi të risqeve dhe jo për qëllime fitimi nëpërmjet spekulimit.

5. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.3. Rreziku i kreditit

Emetuesit e instrumentave financiare në portofol mund të dështojnë në pagesat e interesit ose kryegjësë. Rënia e cilësisë së kreditit mund të vijë nga rënia në vlerë dhe likuiditetit të instrumentave të tregut. Një rritje në hapësirat e kredisë mund të ulë vlerën e tregut të instrumentave duke sjellë një rënie të përgjithshme në vlerën neto të aktiveve të fondit.

Investimet sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pa vonesa dhe të pazhvierësuara		
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11,299,820	12,000,502
Depozita me afat	10,056,164	10,056,164
Llogari të arkëtueshme	414,952	575,582
Total	21,770,936	22,632,248

5.4. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballlet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me pasivet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj nevojave të përditshme për burime monetare, kryesisht për të shlyer detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj normal. Drejtimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke bërë parashikime për flukset e parave.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare sipas maturimit duke u bazuar në periudhën e mbetur nga data e raportimit deri në datën e maturimit sipas kontratës. Shumat e paraqitura në tabelën më poshtë janë flukset e parave të pa skontuara sipas kontratës. Balancat deri në 12 muaj barazohen me vlerën e tyre kontabël sepse ndryshimi me vlerën e skontuar nuk është i konsiderueshëm.

"WVP Fund Management Tirana" sh.a
 Shoqëri Administruese e Fondeve të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive
 31 dhjetor 2019
 (të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.4. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2019	Vlera kontabël	Flukset monetare	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet	E pa percaktuar
Aktive Monetare									
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11,299,820	11,299,820	11,299,820	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat	10,056,164	10,193,836	-	-	-	10,193,836	-	-	-
Llogari të arkëtueshme	414,952	414,952	414,952	-	-	-	-	-	-
Totali i aktiveve	21,770,936	21,908,608	11,714,772	-	-	10,193,836	-	-	-
Detyrimet monetare									
Llogari të pagueshme dhe të tjera	360,089	360,089	360,089	-	-	-	-	-	-
Detyrime të qirasë	1,862,503	2,155,329	36,531	73,062	109,593	219,186	1,716,957	-	-
Total i detyrimeve	2,222,592	2,515,418	396,620	73,062	109,593	219,186	1,716,957	-	-
Pozicioni neto	19,548,344	19,393,190	11,318,152	(73,062)	(109,593)	9,974,650	(1,716,957)	-	-
Efekt akumuluar			11,318,152	11,245,090	11,135,497	21,110,147	19,393,190	19,393,190	19,393,190

31 dhjetor 2018	Vlera kontabël	Flukset monetare	Më pak se 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	>5 vjet	E pa percaktuar
Aktive Monetare									
Mjete monetare dhe ekuivalentë	12,000,502	12,000,502	12,000,502	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat	10,056,164	10,193,836	-	-	-	10,193,836	-	-	-
Llogari të arkëtueshme	575,582	575,582	575,582	-	-	-	-	-	-
Totali i aktiveve	22,632,248	22,769,920	12,576,084	-	-	10,193,836	-	-	-
Detyrimet monetare									
Llogari të pagueshme dhe të tjera	252,747	252,747	252,747	-	-	-	-	-	-
Detyrime të qirasë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Total i detyrimeve	252,747	252,747	252,747	-	-	-	-	-	-
Pozicioni neto	22,379,501	22,517,173	12,323,337	-	-	10,193,836	-	-	-
Efekt akumuluar			12,323,337	12,323,337	12,323,337	22,517,173	22,517,173	22,517,173	22,517,173

5.5. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përbëhet nga rreziku i normave të interesit dhe rreziku i luhatjes së kurseve të këmbimit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Ekspozimet në monedhë të huaj përmbajnë rrezikun e lëvizjeve jo të favorshme në kursin e këmbimit. Aktivitet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë.

Aktive	në LEK	në EUR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11,285,538	14,282	11,299,820
Depozita me afat	10,056,164	-	10,056,164
Llogari të arkëtueshme	414,952	-	414,952
Totali aktiveve	21,756,654	14,282	21,770,936
Detyrime			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	360,089	-	360,089
Detyrime të qirasë	-	1,862,503	1,862,503
Total i detyrimeve	360,089	1,862,503	2,222,592
Pozicioni neto	21,396,565	(1,848,221)	19,548,344

Aktivitet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë.

Aktive	në LEK	në EUR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalentë	11,915,824	84,678	12,000,502
Depozita me afat	10,056,164	-	10,056,164
Llogari të arkëtueshme	575,582	-	575,582
Totali aktiveve	22,547,570	84,678	22,632,248
Detyrime			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	252,747	-	252,747
Total i detyrimeve	252,747	-	252,747
Pozicioni neto	22,294,823	84,678	22,379,501

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhave të huaja

			2019
	Shuma neto	+10%	-10%
EUR	(1,848,221)	(184,822)	184,822
			2018
	Shumaneto	+10%	-10%
EUR	84,678	8,468	(8,468)

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit, dhe një korrigjim të vlerave të tyre është bërë për 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlerat pozitive/negative tregojnë një rritje/ ulje të fitimit ose kapitalit, e cila ndodh kur Leku forcohet/ dobësohet ndaj një monedhe të huaj me +/- 10%.

5.6. Rreziku operacional

Rreziku operacional përbën rrezikun e humbjeve nga mos-funksionimi i sistemeve dhe i procedurave të brendshme. Shoqëria ka përpiluar procedura të brendshme dhe sisteme kontrolli për minimizimin e rrezikut operacional. Shoqëria ka krijuar sisteme të brendshme kontrolli që mënjanojnë mosfunksionimin e proceseve.

6. Paraqitja me vlerë të drejtë

Vlerësimet e vlerave të drejta janë bazuar në paraqitjen e pozicionit financiar të instrumenteve ekzistuese financiare pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të prishëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumenta financiare.

	Me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humjes	Me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2018					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	-	-	11,299,820	11,299,820	11,299,820
Depozita me afat	-	-	10,056,164	10,056,164	10,056,164
Llogari të arkëtueshme	-	-	414,952	414,952	414,952
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	-	-	360,089	360,089	360,089
Detyrime të qirasë	-	-	1,862,503	1,862,503	1,862,503

	Me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humjes	Me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Me kosto të amortizuar	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2018					
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	-	-	12,000,502	12,000,502	12,000,502
Depozita me afat	-	-	10,056,164	10,056,164	10,056,164
Llogari të arkëtueshme	-	-	575,582	575,582	575,582
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	-	-	252,747	252,747	252,747
Detyrime të qirasë	-	-	-	-	-

Matja e vlerës së drejtë përfshirë në informacionin shpjegues të pasqyrave financiare për 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është bazuar në Nivelin 3 të hierakisë.

7. Aktive Afatgjata Jomateriale

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to janë të përbëra si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Totali
Kosto		
Gjendja më 1 janar 2018	-	-
Shtesa	3,963,300	3,963,300
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,963,300	3,963,300
Shtesa	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,963,300	3,963,300
Amortizimi i akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2018	-	-
Shpenzimi për vitin	(148,623)	(148,623)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	(148,623)	(148,623)
Shpenzimi për vitin	(190,732)	(190,732)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(339,355)	(339,355)
Vlera Neto		
Më 1 janar 2018	-	-
Më 31 dhjetor 2018	3,814,677	3,814,677
Më 31 dhjetor 2019	3,623,945	3,623,945

8. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivët afatgjata materiale janë të përbëra si më poshtë:

	Ndërtesa	Pajisje Zyre	Pajisje kompjuterike	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2018	-	-	742,320	742,320
Shtesa	-	167,640	16,500	184,140
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	167,640	758,820	926,460
Rregullimi për aplikimin fillestar të IFRS 16	2,208,275	-	-	2,208,275
Riparaqitur 1 janar 2019	2,208,275	167,640	758,820	3,134,735
Shtesa	-	-	87,500	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,208,275	167,640	846,320	3,222,235
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2018	-	-	-	-
Shpenzimi për vitin	-	(19,559)	(187,434)	(206,993)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	(19,559)	(187,434)	(206,993)
Shpenzimi për vitin	(373,229)	(29,616)	(162,325)	(565,170)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	(373,229)	(49,175)	(349,759)	(772,163)
Vlera Neto				
Më 1 janar 2018	-	-	742,320	742,320
Më 31 dhjetor 2018	-	148,081	571,386	719,467
Më 31 dhjetor 2019	1,835,046	118,465	496,561	2,450,072

Ndërtesat në vlerë kontabël neto 1,835,046 lekë më 31 dhjetor 2019 përfaqësojnë aktive të të drejtës së përdorimit.

9. Llogari të arkëtueshme dhe parapagime

Të arkëtueshme nga Fondet përfaqësojnë vlerën e tarifës së administrimit të përlogaritur mbi aktivet neto të Fondit të Investimit, të cilat kanë mbetur të papaguar në fund të vitit.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga Fondi Investimit	414,952	575,582
Parapagim Tatimi mbi Fitimin	20,000	20,000
Totali	434,952	595,582

10. Depozita me afat

Depozitat me afat me bankat përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Depozitë me afat në Union Bank (pa rating)	10,000,000	10,000,000
Interes i përlogaritur	56,164	56,164
Totali	10,056,164	10,056,164

Depozita me afat në Union Bank përfaqëson një depozitë në Lek e cila mbart interes me normë 2.5% dhe maturohet më 11 tetor 2020.

11. Mjete monetare dhe ekuivalentët me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Arka		
ALL	36,831	32,079
	36,831	32,079
Banka		
Llogari rrjedhëse		
ALL	493,309	6,873,107
EUR	14,282	84,678
	507,591	6,957,785
Depozitë pa afat		
ALL	10,755,398	5,010,638
	10,755,398	5,010,638
Totali	11,299,820	12,000,502

Llogarite rrjedhese dhe depozitat pa afat jane te vendosura ne banka tregtare vendase te pa vleresuara.

12. Kapitali Aksionar

Më 31 dhjetor 2019, kapitali aksionar i regjistruar është 28,600,000 lekë, dhe përbëhet nga 13,000 aksione me vlerë nominale 2,200 lekë (2018: Kapitali aksionar 28,600,000 Lekë). Struktura aksionare bazuar në kapitalin e paguar tërësisht dhe të regjistruar ishte si vijon:

	31 dhjetor 2019			31 dhjetor 2018		
	Në %	Numër aksionesh	Në Lek	Në %	Numër aksionesh	Në Lek
WVP Fund Management AD Shkup	51.00%	6,630	14,586,000	51.00%	6,630	14,586,000
"WVP"- "NDERMJETESIM NE SIGURIME"	25.00%	3,250	7,150,000	25.00%	3,250	7,150,000
Arton Lena	12.31%	1,600	3,520,000	13.31%	1,730	3,806,000
Rubert Strobl	4.00%	520	1,144,000	4.00%	520	1,144,000
Kujtim Ibraimi	4.19%	545	1,199,000	4.19%	545	1,199,000
Ardian Kelmendi	2.50%	325	715,000	2.50%	325	715,000
Ogjen Tillikj	1.00%	130	286,000	-	-	-
Totali	100%	13,000	28,600,000	100%	13,000	28,600,000

Kjo strukturë është aprovuar nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin Nr. 28, datë 08.03.2019 dhe u regjistrua në QKR më 18.03.2019.

13. Qiratë

Detyrimet e qirasë sipas maturitetit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime Afatshkurtra	335,755	-
Detyrime Afatgjata	1,526,748	-
Totali	1,862,503	-

Shoqëria ka marre me qira ambientet ku zhvillon aktivitetin e saj kryesor. Me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët, çdo qira pasqyrohet në bilanc si një aktiv i të drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje. Shoqëria i klasifikon aktivet e të drejtës së përdorimit në mënyrë konsistente në Aktive Afatgjata Materiale (shiko Shënimin 10).

Shoqëria ka vetëm një kontratë qiraje për të cilën ka njohur aktivin e të drejtës së përdorimit me afat të mbetur 5 vjet. Kontrata e qirasë i jep të drejtën e përdorimit për qëllime të aktivitetit të saj shoqërisë si dhe të drejtën e dhënies me nënqira të aktivi të të drejtës së përdorimit. Qiraja është anulueshme vetëm duke paguar një tarifë për përfundimin e parakohëshëm të kontratës. Shoqëria e ka të ndaluar shitjen apo lënien garanci të pasurive themelore të marra me qira. Shoqëria duhet t'i mbajë ambientet e marra me qira në një gjendje të mirë dhe t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale në fund të qirasë.

12. Qiratë (vazhdim)

Detyrimet e qirasë sigurohen nga aktivet e të drejtës së përdorimit të lidhura me to. Pagesat minimale të qirasë në të ardhmen si më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Më pak se 6 muaj	Midis 6 dhe 12 muaj	1-5 vite	mbi 5 vite	Totali
31 Dhjetor 2019					
Pagesat e qirasë	219,186	219,186	1,716,957	-	2,155,329
Shpenzimet e interes	(53,820)	(48,797)	(190,209)	-	(292,826)
Vlera aktuale neto	165,366	170,389	1,526,748	-	1,862,503
31 Dhjetor 2018					
Pagesat e qirasë	-	-	-	-	-
Shpenzimet e interes	-	-	-	-	-
Vlera aktuale neto	-	-	-	-	-

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka angazhime për kontratat afatshkurtra të qirasë.

14. Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme dhe të tjera detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2018
Rampu Agency	49,200	36,000
Primera Invest	147,016	-
Paga të Pagueshme	163,873	216,747
Të pagueshme për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore dhe TAP	84,130	96,661
Tatim në burim	11,057	5,591
Total	455,276	354,999

15. Të ardhura nga tarifa e administrimit

Të ardhura nga tarifat e administrimit detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga komisionet e hyrjes (Entry Fee)	5,154,100	3,580,500
Të ardhura nga komisionet e administrimit të Fondeve	1,942,924	1,249,351
Totali	7,097,024	4,829,851

16. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesi i investimeve në letra me vlerë	-	211,291
Të ardhura nga interesi i depozitave	359,234	66,830
Totali	359,234	278,121

17. Shpenzime për personelin

Shpenzimet për personelin detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime personeli	2,980,475	3,774,146
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	490,864	423,194
Totali	3,471,339	4,197,340

18. Shpenzime të përgjithshme administrative

Shpenzime të përgjithshme administrative detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime per Qira	-	460,710
Shpenzime per kontabilitet dhe auditim	804,742	528,000
Shpenzime për konçesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	758,635	300,000
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	81,312	107,565
Taksa dhe tarifa vendore	67,000	78,167
Shpenzime per sherbimet bankare	83,284	67,010
Shpenzime Kancelarike	66,390	16,748
Shpenzime Noteriale	38,880	21,640
Udhëtime dhe transport	-	10,043
Sherbim marketingu	1,696,968	-
Sherbim kosulence financiare dhe manaxheriale	493,000	-
Shpenzime të tjera	294,862	251,387
Totali	4,385,073	1,841,270

Shpenzimet e auditimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 ishin në shumën 171,564 lekë.

19. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Fitimi neto llogaritur si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Humbja Bruto	(1,284,219)	(1,531,843)
<i>Shpenzime të panjohura</i>		
Shpenzime amortizimi nga aplikimi IFRS 16	123,581	-
Shpenzime interesi nga aplikimi IFRS 16	373,229	-
Shpenzime të tjera të panjohura	91,063	107,301
	587,873	107,301
<i>Shpenzime të zbritshme</i>	(443,478)	-
Pagesta e qirasë		-
Humbje e mbartur	(1,661,306)	(236,764)
Baza e llogaritjes së Tatimit	(2,801,130)	(1,661,306)
% e tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	-	-
Humbja neto	(1,284,219)	(1,531,843)

20. Transaksionet me palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një person apo një entitet që ka kontroll apo kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë, ka aftësinë të ushtrorë influencë të konsiderueshme mbi Shoqërinë në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, është anëtar i personelit të drejtimit kyç të Shoqërisë apo të një Shoqërie mëmë të Shoqërisë, si dhe është pjesë e të njëjtit grup me Shoqërinë, është filial, investim në pjesëmarrje apo apo shoqëri mbi të cilën Shoqëria ushtron kontroll apo influencë të konsiderueshme. Gjithashtu konsiderohet palë e lidhur një shoqëri që ka një sipërmarrje të përbashkët me Shoqërinë apo dy entitete të cilat janë sipërmarrje të përbashkëta të një shoqërie të tretë. Një numer i caktuar transaksionesh me palë të lidhura janë ndermarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë bërë sipas afateve dhe normave të tregut. Transaksionet me fondin e Investimit janë të paraqitura në shënimin 9 dhe shënimin 15.

Volumi i këtyre transaksioneve dhe balancat në fund të periudhave respektive janë si vijojnë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktive		
Mjete Monetare në First Investment Bank	11,015,689	11,965,923
Të arkëtueshme nga Fondi i Investimit	414,952	575,582
	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura		
Të ardhura nga interesat First Investment Bank	109,234	10,666
Shpenzime		
Shpenzime për komisione First Investment Bank	76,584	66,010
Shpenzime për shpërblimet e drejtimit	1,710,594	2,572,279

21. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje ligjore

Gjatë aktivitetit të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në dëme dhe çështje ligjore. Në gjykimin e drejtimit, nga dispozitat e fundit për këto çështje, shoqëria nuk do të ketë ngjarje me peshë të konsiderueshme për të ndikuar në pozicionin financiar të saj ose për të ndryshuar vlerën neto të aktiveve, përveç atyre për të cilat është njohur një provizion në pasqyrat financiare.

Detyrime të kushtëzuara

Shoqëria nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme të kontraktuara deri në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

22. Ngjarje pas dates së raportimit

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka patur ndikim të rëndësishëm në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë operacionet për periudha të gjata ose të pacaktuara kohore. Masat e marra për të ngadalësuar përhapjen e virusit, të cilat përfshijnë ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin shoqëror dhe mbylljen e shërbimeve jo thelbësore, kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Tregjet globale të aksioneve kanë provuar gjithashtu një paqëndrueshmëri të madhe dhe një dobësim të ndjeshëm. Qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për të stabilizuar kushtet ekonomike. Edhe Qeveria e Shqipërisë ka marrë një sërë masash në kuadër të ngadalësimit të përhapjes së virusit të cilat përfshijnë shtyrjen e kësteve të kredive për tre muaj për bizneset dhe individët të cilët kanë patur vështirësi ekonomike për shkak të masave të marra për ngadalësimin e përhapjes së virusit, shtyrjen e pagesave të qirave për tre muaj, si dhe një sërë masash për ndalimin e bizneseve që konsiderohen jo thelbësore dhe me rrezik për përhapjen e sëmundjes dhe kufizimin e lëvizjes së lirë të njerzve brenda fashave orare të përcaktuara.

Shoqëria ka marrë masa për vazhdimin e operacioneve të saj në përputhje me masat e marra nga Qeveria e Shqipërisë duke vijuar me punën në distancë dhe shërbimet e pagesave e-banking.

Shoqëria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së bilancit të cilat nuk kërkojnë korrigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e operacioneve më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2019 nuk janë korigjuar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së aprovimit të pasqyrave financiare e cila mund të kërkojë rregullime ose shënime shtesë në këto pasqyra financiare.